



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:300948

Datë: 19.12.2024

Numri i dokumentit: 06627567

**C.nr.3250/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË MIROVICË**, si kontestimore, me Gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike të paditëses K.H. nga Mitrovica, përfaqësuar nga Leutrim Ademi av me seli në Mitrovicë, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DKA, Objekti i Kontesti Pagesë Kujdestarie, jashtë seance me dt. 19.12.2024 nxjerr këtë;

**A K T V E N D I M**

Padia e paditëses K.H. nga Mitrovica, e parashtruar në këtë gjykatë me dt. 26.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DKA, Objekti i Kontesti Pagesë Kujdestarie, me vlerë të kontestit të papërcaktuar, **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

**A r s y e t i m**

Paditësja K.H. nga Mitrovica, përmes të autorizuarit, ka ushtruar padi me dt. 26.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DKA, Objekti i Kontesti Pagesë Kujdestarie, me vlerë të kontestit të papërcaktuar.

Gjykata, me aktvendimin e dt. 12.11.2024, të pranuar nga i autorizuari i paditëses me dt. 19.11.2024, ka kërkuar nga paditësja që brenda afatit 3 ditor ta plotësoj- precizoj padinë, me paralajmërimin konform nenit 99 dhe 102 te LPK-së.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se paditësja nuk ka vepruar brenda afatit të përcaktuar nga gjykata për plotësimin- precizin e padisë, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 102.par 3 të LPK-së, padinë e paditëses K.H. nga Mitrovica, e parashtruar në këtë gjykatë me dt. 26.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DKA, Objekti i Kontesti Pagesë Kujdestarie, me vlerë të kontestit të papërcaktuar, e **KONSIDEROJ TË TËRHEQUR**.

Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në vështrim të nenit 102.par 3 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.3250/2024 me dt.19.12.2024**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 7 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.